



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060 101-2011 dt. 16 101 2026

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Burim Bujupi, më datë: 30.01.2026 (e mërkurë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të këtë

Rend dite:


1. Mehedin Salihu, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas nga subjekti politik "Për Drenas e Kosovë", duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Salih Dvorani.
2. Procesverbali i mbledhjes inauguruese të Kuvendit Komunal i dt. 10.12.2025.
3. Procesverbali i mbledhjes se jashtëzakonshme i Kuvendit Komunal i dt. 17.12.2025.
4. Procesverbali i mbledhjes se jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal i dt. 24.12.2025.
5. Propozim vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Nr. 02 Nr. 020/04-53198 të datës 18.12.2025.
6. Propozim vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit komunal të aksionareve për kompaninë rajonale të mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Drenas.
7. Propozim vendim për plotësim-ndryshimin e komisionit komunal të aksionareve për NPL "Stacioni i Autobusëve Sha.A Glllogoc.
8. Propozim vendim për miratimin paraprak të te vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik-juridik (99 vite).
9. Raport i punës së kryetarit dhe drejtorive të Komunës së Drenasit për vitin 2025.
10. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2025.
11. Njoftim lidhur me vërshimet në territorin e Komunës së Drenasit.
12. Të ndryshme.

Drenas, 16.01.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) Ligjit Nr.03L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 23.12.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z.Mehedin Salihu**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Glllogoc, nga subjekti politik "Për Drenas e Kosovë", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal **z.Salih Dvorani**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet Mehedin Salihu dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 23.12.2025 me numër të protokollit 07/7-4105/2025, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal, i cila ka dhënë dorëheqje, për arsye personale. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është Mehedin Salihu. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 23.12.2025

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-53137 dt. 17/12/2025

Mbledhja Inauguruese
Kuvendi Komunal
10.12.2025

PROCESVERBALI

I mbledhjes Inauguruese të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 10.12.2025
Bazuar në UD (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e kryesoi anëtarë me i vjetër i Kuvendit Komunal: z.Liman Krasniqi.
Kryesuesi i mbledhjes deklaroi të hapura punimet e mbledhjes Inauguruese të Kuvendit Komunal,
ku të pranishëm ishin 27 anëtarë të Kuvendit Komunal.
Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

- 10:00-10:15. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë;
- Hapja me Himnin e Flamurit
- Një minutë Heshtje për Dëshmorët
- 10:15- 10:30- Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës;
- 10:30- 10:45- Kryesuesi i mbledhjes Fton natarët e kuvendit
 - Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;
 - Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;
- 10:45-11:00- Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës;
- 11:00-11:15 - Mbyllja e seancës.

Prezent gjatë seancës inauguruese ishin: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës së Drenasit Arben Shala, të gjithë anëtarët të rinj të Kuvendit Komunal, përfaqësues të Policisë së Drenasit, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të Handikos-it, përfaqësues të i

nvalidëve të luftës, përfaqësues të shoqatës së invalidëve të luftës, përfaqësues të veteraneve të luftës, përfaqësues të BIK-it, përfaqësues të shoqatës të drejtave të grave, familjaret e kryetarit, zyra për informim, drejtor të drejtorive komunale, zyrtar komunal.

Mbledhja filloj me:

- **Hapjen e Himnit të Flamurit**
- **Një minutë Heshtje për Dëshmorët**
- **Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës**

Liman Krasniqi- përshëndeti të gjithë të pranishmit me këtë fjalim: të nderuar përfaqësues të institucioneve komunale në Drenas, të nderuar qytetar të komunës tonë, mirë se keni ardhë në këtë mbledhje inauguruese të Kuvendit Komunal.

Pasi me ra fati të jam anëtar i ma i moshuar në asamblenë e tashme të Kuvendit Komunal në Drenas, shkrytëztoj rastin të ju përshendes në emer të asambleistëve të gjithë juve pjesmarrës të familjeve të dëshmorëve, veteranët e luftës, përfaqësues të institucioneve, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e strukturave komunale, qytetarët e komunës tonë dhe kryetarin e komunës z.Ramiz Lladrovci të cilit i uroi punë të mbarë dhe sukses me struktura të asambleistëve dhe njëherit i uroi bashkëpunim të ngushtë me asambleistët për interesa të popullatës të komunës tonë pa dallim partie apo grupit partiak.

Në vazhdim ju uroi sukses dhe punë të mbarë të gjithë asambleistëve të kësaj garniture me shpresën se do të jemi unik në vendimet tona, për zbatimin planit zhvillimor dhe urban për krijimin e bazamentit për zhvillimin ekonomik, social, shendetësor, në krijim të kushteve ma të mira në arsim si në infrastrukturën e objekteve dhe paisjeve teknologjike, po ashtu edhe në personelin kadrovik për fund edhe njëherë urime të gjithëve dhe punë të mbarë.

z. Liman Krasniqi- Ftoj të gjithë asambleistët të ngritën në këmbë dhe për ta dhënë betimin njëzëri.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal dhanë betimin njëzëri- Betohem

-Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;

Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glllogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë” Betohem.

Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;

z.Ramiz Lladrovci – betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Drenasit (Glllogocit) me nder, besnikëri, në mënyrë të

paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë” Betohem.

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.

Sot, për herë të katërt dhashë betimin si Kryetar i komunës pas konstituimit të Kuvendit të ri të Drenasit,

Jam i nderuar dhe privilegjuar që për herë të katërt, të mbaj fjalim para të zgjedhurve të përbërjes së re kuvendore, në Kuvendin e Drenasit, në zemrën e Kosovës.

Një ditë gjatë katër viteve jam plotësisht politik, ditën kur votoj, të gjitha ditët tjera, jam njëri nga ju që drejtoj komunën me besimin e qytetarëve me integritet, i zgjedhur nga qytetarët që dhanë shumë për lirinë e Kosovës,

Më kanë zgjedhur qytetarët që dhanë shumë për shtet ndërtim,

Qytetarë që ishin pjesë aktive e rezistencës shekullore, që kulmoi me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe çlirimin e vendit.

Të nderuara asambliste dhe asamblastë,

Me këtë fjalë të shkurtër rasti, ritheksoj përkushtimin tim për qeverisje të bazuar në ligj, me transparencë dhe llogaridhënie, qeverisje e mirë e cila çdo vit matet nga faktorët vendorë e ndërkombëtar, ku qeverisja jonë është vërtetuar shtatë herë e para në Kosovë.

Në bashkëpunim me juve, shpresoj të bëhemi dhjetë herë kampion të qeverisjes së mirë në nivel vendi.

Uniteti i kësaj përbërjeje të Kuvendit, pres sjell projekte të mira për qytetarët, jam i gatshëm të punoj bashkë për mirëqenien e qytetarëve, do të finalizojmë projektet në proces si dhe projektet e reja.

Të nderuar të pranishëm,

Qytetarë të dashur,

Bashkë, pres të bëjmë punë të mira, duke zbatuar ligjin, gjasat e mundësitë e barabarta.

Uniteti i grupeve kuvendore, bashkëpunimi me qytetarët dhe nivelin qendror, do të sjellin energji pozitive për ta bërë Drenasin sa më tërheqës për të jetuar, për të punuar dhe për të investuar në zemrën e Kosovës.

Dua ta falënderoj përbërjen Kuvendit të Drenasit në mandatin 2021-2025, të cilët njëzëri kanë përkrahur shpalljen e disa personaliteteve “Qytetar nderi”.

Bashkë me juve, gjatë vitit që vjen, shpresoj fort se titullin “Qytetar nderi”, do tua japim këtu, në këtë Sallë, heronjve tanë të luftës dhe paqes, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Të nderuara asambliste dhe asamblistë,

Më lejoni të shpreh nderimin dhe konsideratën për të gjithë qytetarët e komunës tonë, të cilët gjatë procesit zgjedhor, manifestuan kulturë, mirësjellje dhe mirëkuptim ndër qytetar.

Jam i nderuar përjetësisht, të jem në krye të komunës me qytetarë të ndershëm e punëtorë, në krye të komunës e cila zbaton barazinë gjinore dhe respekton bindjet e ndryshme politike.


Jam i lumtur të jem në krye të komunës e cila është shembull i qeverisjes së mirë, transparente dhe llogaridhënëse.

Bashkë, do të bëjmë më të mirën për qytetarët kampion, të komunës shtatë herë kampion, në zemrën e Kosovës.

Liman Krasniqi – konsideroj të mbyllur seancën inauguruese pas dhënies së betimit të anëtareve të Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës duke ju uruar suksese të gjithë anëtareve të Kuvendit Komunal.

Mbyllja e seancës- seanca përfundoj rreth orës 10:30

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Mbledhjes
Liman Krasniqi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/01-2595 dt. 16/01 2026

PROCESVERBALI

I mbledhjes së zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë:
17.12.2025

Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal: Liman Krasniqi

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 27 anëtarët e kuvendit të komunës.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

Rend dite:

1. Zgjedhja e Kryesuesit/ës të Kuvendit të Komunës.
2. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
3. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
4. Propozim vendim për themelimin e Këshillit për siguri në Bashkësi.

Prezent gjatë mbledhjes se rregullt ishin 27 anëtar të Kuvendit Komunal, Nënkryetari i Komunës së Drenasit Arben Shala si dhe stafi i kryetarit.

Anëtari me i vjetër Liman Krasniqi , e hapi mbledhjen e Kuvendit të Komunës, fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse konstatoj se prezent ishin 27 anëtar, andaj korumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë, dhe ju njoftoj me rendin e ditës:

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Liman Krasniqi hodhi në votim rendin e ditës ku të pranishëm ishin 27 anëtar dhe të gjithë votuan në mënyrë unanime.

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, sipas proceduarave ligjore, fillimisht duhet të formohet komisioni për mbarrëvajtjen e zgjedhjes së kryesuesit

Arbër Halilaj propozoi që komisioni të formohet nga pesë anëtarë dhe të këtë sa më shumë përfaqësim që secili subjekt të përfaqësohet nga anëtari i vet.

Anëtari me i vjetër Liman Krasniqi, konstatoje që shumica e anëtareve të kuvendit është që komisioni të përbëhet nga pesë anëtarë, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit Komunal të votojnë përbërjen e komisionit.

Nga grupi Kuvendar i PDK-së, Zeqir Hasi propozon Artian Krasniqi për anëtar të komisionit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Gani Krasniqi nga Grupi Kuvendar i PDKRLL propozoi për anëtar të komisionit Valdet Curri.

Nga Grupi Kuvendar VV Xhavit Drenori propozoi për anëtar të komisionit Egzona Tërdevci ,

Nga Grupi Kuvendar LDK Egzon Qorri propozon për anëtar të komisionit Arbër Halilaj .

Nga Grupi Kuvendar GREEN Arbër Halilaj propozon për anëtar të komisionit Egzon Qorri.

Liman Krasniqi, fton anëtarët e Kuvendit Komunal që të votojnë komisionin me përbërje:

1. Artian Krasniqi -PDK
2. Valdet Curri – PDKRLL
3. Egzona Tërdevci - VV
4. Arbër Halilaj -BD
5. Egzon Qorri- LDK

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Liman Krasniqi hodhi në votim komisionin për zgjedhje të kryesuesit i cili u votua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal.

Anëtari me i vjetër Liman Krasniqi- ftoj grupet e kuvendare që të propozojnë kandidatin për kryesues të Kuvendit Komunal.

Gani Krasniqi nga grupi parlamentar i PDKRLL-së propozon për kryesues të Kuvendit Komunal Burim Bujupi.

Zeqir Hasi nga grupi parlamentar i PDK-së propozon për kryesues të Kuvendit Komunal Driton Ajazi

Shkojmë me dhjetë minuta pauzë deri sa sekretaria e kuvendit ti bëjë gati materialet për votimin e kryesuesit të kuvendi të komunës së Drenasit.

Anëtari me i vjetër Liman Krasniqi konstatoj që të pranishëm janë 27 anëtarët e kuvendit po ashtu kërkoj nga komisioni që të verifikojë fletëvotimet a janë në rregull si dhe të sqarojnë mënyrën e votimit, pas verifikimit të komisionit vazhdojmë me procedurat e votimit, votimi i zgjedhjes së kryesuesit bëhet me vota të fshehta

Fillon votimi për kryesues sipas regjistrimit në listën e anëtareve të Kuvendit të Komunës,

komisioni ka konstatuar se nga 27 votues 26 vota kanë qenë të vlefshme kurse një votë ka qenë e pavlefshme

Anëtari me i vjetër Liman Krasniqi konstaton se me raundin e parë u zgjodh për Kryesues të Kuvendit Komunal Burim Bujupi, me 15 vota për, kurse Driton Ajazi kishte 11 vota, e ftojë zotri Burim Bujupi që të marr fjalën dhe të vazhdojë me procedurat e me tutjeshme dhe i urojë fat dhe punë të suksesshme dhe bashkpunim me të gjitha grupet kuvedare Burim Bujupi faleminderit të gjithëve për besimin dhe votën që me keni dhënë që unë të jem kryesues i kuvendin komunal të Drenasit urojë që këtë të mirë besim të kthej me ndershmëri punë dhe angazhim.

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi kërkon 15 minuta pauzë për pikat e tjera të rendit të ditës.

Pas përfundimit të pauzës vazhdojmë pa humbur kohë me pikat e radhës që është pika e dytë e rendit të ditës 2. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa. Ky komitet përbehet nga 7 anëtar, unë mendoj të formohet nga shtatë anëtarë në qoftëse edhe ju jeni të pajtimit .

Zeqir Hasi të uroi për zgjedhjen si kryesues i kuvendit komunal na shkoftë puna mbarë unë dhe grupi kuvendar i PDK-së pajtohem që të jenë shtatë anëtarë .

Gani Krasniaqi edhe nga grupi PDKRLL pajtohem që të jenë shtatë anëtarë.

Egzona Terdevci nga LVV edhe ne jemi dakord për me qenë shtatë anëtarë.

Arbër Halilaj nga BD është një udhëzim administrativ që e përcakton që duhet të këtë një përfaqësim sa më të gjerë të subjekteve kështu që duhet të jenë shtatë anëtarë në këtë komitet.

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës

2. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Për 26 vota Kundër 0, Abstenim 0

Siq e dini në bazë të përfaqësimit politik partitë politike që kanë fituar më shumë ulëse kryesuesi shkon me automatizëm i edhe dy anëtarë të PDKRLL, dy PDK-së një VV dhe një nga katër anëtarët tjerë të partive të ndryshme siç janë BD, LDK, NISMA dhe Për Drenas e për Kosovë Gani Krasniaqi Nga grupi kuvendari PDKRLL-së propozojmë Selman Qallapekun, Fitore Morina

Zeqir Hasi nga grupi kuvendar i PDK-së propozojmë Zeqir Hasi, Arigon Sinani

Xhavit Drenori nga grupi kuvendar i VV-së propozojmë Egzona Terdevci.

Le të mbetet për procesverbal sepse ne jemi dakorduar me partnerin e koalicionit që me pas me rotacion dy vite VV pastaj partneri i koalicionit.

Nga bashkimi demokratit unë do të përfaqësojë komitetin për politik e financa.

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi prezanton emrat për anëtarë të komitetit për politik e financa nga grupi kuvendari PDKRLL-së Selman Qallapekun, Fitore Morina, grupi kuvendar i PDK-së propozon Zeqir Hasi, Arigon Sinani, nga grupi kuvendar i VV-së propozojmë Egzona Terdevci, BD Arbër Halilaj, meqensë janë dy gra besoj që plotësohet kuota gjinore .

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës me këtë përbërje: Selman Qallapekun, Fitore Morina Zeqir Hasi ,Arigon Sinani, Egzona Terdevci,Arbër Halilaj e cila u votua në mënyrë unanime.

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e tret 3,Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete, sipas rregullores ky komiete përbëhet prej 5 anëtareve dy nga PDKRLL dy nga PDK dhe një nga partitë tjera .

Gani Krasniaqi nga grupi kuvendari PDKRLL-së propozojmë Naim Gjeli, Erblinë Morina Zeqir Hasi nga grupi kuvendar i PDK-së propozon Jahir Hajdari dhe Pajtime Berisha Egzon Terdevci propozon Egzon Qorri si anëtar të komitetit për komunitete .

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi prezanton anëtarët që do të përbëjnë komitetin për komunitete, nga grupi kuvendari PDKRLL-së propozojmë Naim Gjeli, Erblinë Morina, nga grupi kuvendar i PDK-së propozon Jahir Hajdari dhe Pajtime Berisha dhe Egzon Qorri nga LDK. Egzona Terdevci ka të drejt sekretarija po unë propozoj që tash nëse mbrijnë me i gjet dy anëtar prej shoqërisë civile dy grupet me të mëdhaja me bërë kompromis me hjek nga njërin propozim që e kanë edhe me vazhdu me u përfshir grupet tjera.

Gani Krasniaqi propozon një ndryshim në vend të Nami Gjelit shkon Edon Nishori Mërgim Pirraku, me qenë se është shumë e qartë, sipas ligjit kisha kërku me e lanë për mbledhjen e ardhshme mos me dërgu në MAPL pasi që e dijmë përgjigjejen se qfarë do të na kthejnë .

Xhavit Drenori nëse udhëzimi është i qartë ne vetëm duhet me i reduktuar dy emra në qoftëse sot dojnë me u votu tre tjerë le të votohen në mbledhjen e radhës vijnë propozimet prej shoqërisë civile edhe kryhet.

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi me qensë kemi pa qartësi me këtë pikë propozojë të shtyjme për mbledhjen e radhës i marrim edhe emrat e shoqërisë civile e hodhim në votim që kjo pikë të kalojë për mbledhjen e radhës, dhe me shumicën e votave kjo pikë shtyhet për mbledhjen e radhës, edhe pika e katër 4,Propozim vendim për themelimin e Këshillit për siguri në Bashkësi shtyhet për seancën e radhës

Pasi nuk pati pyetje as diskutime tjera kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi e shpalli mbledhjen të mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 17.12.2025 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të <https://www.facebook.com/share/v/1KE4FkmyB/>

Procesmbajtëse:


Fakete Hoti



Kryesuesi i kuvendit komunal Drenas

Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/b1-2596 dt. 16/01/ 2026

PROCESVERBALI

I mbledhjes se jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë:

24.12.2025

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi Kuvendit Komunal: Burim Bujupi

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 25 anëtarët e kuvendit të komunës.

Në mbledhje munguan Zeqir Hasi dhe Erblinë Morina

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

Rend dite:

1. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
2. Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi.
3. Plani i punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026.
4. Plani i Punës së Kryetarit dhe drejtorive komunale për vitin 2026.
5. Plani Lokal i veprimit në mjedis 2025-2029.
6. Hartimi i planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit – Komuna e Drenasit 2025-2029.
7. Plani komunal për integritet i Komunës së Drenasit i përditësuar për vitin 2026.
8. Plani i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Gllogocit 2026–2029
9. Plani i Reagimit Emergjent (PRE) për Komunën e Gllogocit.
10. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.
11. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025.
12. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2026.

13. Raporti i vlerësimit të menaxhimit të rreziqeve të Komunës së Drenasit për vitin 2025.
14. Raporti Financiar Janar-Shtator 2025.
15. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBB-së për periudhën Janar-Dhjetor 2025
16. Diskutimi i Raportit të Përformancës Komunale për vitin 2024.

Prezent gjatë mbledhjes ishin 25 anëtar të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci si dhe stafi i kryetarit.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi pasi prezantoi rëndin e ditës fjalën e merr: **Ezona Terdevci**, faleminderit kryesues merr si përgjegjësi që prej detyrave të para me qenë rregullimi i mikrofonave në sallën e kuvendit komunal, e pata një diskutim të shkurtër të pika e dytë e kemi fol edhe në seancën e kaluar përfaqësuesi nga komiteti për komunitete duhet me qenë kryetari i këtij komiteti në KKSBB rrjedhimisht nuk është zgjedhur ende kështu që propozoj me shty ose me formu pa përfaqësuesin e komitetit për komunitete me shtua pastaj atë përfaqësues.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci kësaj mbledhje as nuk i hiqen e as nuk i shtohen pikat e rendit të ditës ligji e përcakton kush është kryesuesi në mungesë të tij kush e zëvendëson.

Driton Ajazi, është një plan voluminoz ditor dhe të gjithë kemi pasur probleme teknik me emalin zyrtar dhe si rezultat i kësaj nuk kemi pas qasje me pa materialin që janë shumë pika të rendit të ditës dhe kërkoj që disa nga këto pika të shtyhen për mbledhje të rregullt të kuvendit komunal pikat që kërkoj të shtyhen janë nga pika pesë deri të pika e nëntë.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, këto janë dokumente që duhet me i votu për shkak së këto hyjnë në grandin në performancës komunale sa i përket imellave sekretaria merr me këtë punë ,tregova edhe me herët që as nuk mund të shtojmë as të hjekum pika të rendit të ditës, mundeni me votu kundër punë e imja është me e dërgu me kohë e ju votoni si të doni.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi unë mendoj që ata të cilët kanë problem me imella munden me ju drejtu të sekretarisë dhe me u saqru me në detaje.

Pasi që me nuk pati diskutime, vërejtje apo **sugjerime kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi** hodhi në votim rendin e ditës ku të pranishëm ishin 25 anëtar
Për votua 14 Kundër 0 Abstenim 9

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e parë të rendit të ditës1. Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete;kjo pikë ka qene edhe në mbledhjen e kalume po për shkak të mungeses se emrave nga shoqerija civile e kemi shty për sot.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, anëtarin e shoqërisë civile dhe anëtarin e komunitetit të biznesit përcakton kryetari i komunës ne i kemi dy emra por jemi të gatshem me ja jep mundësin që nëse ju keni emra për këtë komunitet jam i gatshëm me i pranu

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi faleminderit kryetar siç edhe e dini ky komitete formohet nga 5 anëtar 3 anëtar nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile dhe një nga komuniteti i biznesit vazhdojmë me propozimet .

Xhavit Drenori faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë ju urojë të gjithëve bashkërisht të bëjmë punët me të mira për qka edhe jemi deleguar këtu, kryesuesi edhe në të gjithë përbëjmë organin me të lartë që është kuvendi i komunës dhe jemi në shërbim të qytetareve në herën e kaluar patëm 5 emra ,formula ishte dy dy , një gjithmonë po i drejtohem rendit të tretë të subjekteve të tjera unë besoi që është e drejt me shku një një dhe një prapë me mbete prej pjesës të ish opozitës ose opozitës që janë grupe me të vogla me qenëse është formal nuk ka ndonjë rol shumë të madhe dhe ekzekutiv, unë mendoj që subjekti me i madh në këtë rast PDKRLL të ketë një mandat PDK një mandat dhe nga ana jonë e kemi pas Egzon Qorri dhe le të mbetet ai.
Gani Krasniqi nga PDKRLL propozojmë Edon Nishori
Driton Ajazi nga PDK propozojmë Jahir Hajdari
Arbër Halilaj propozon Egzon Qorri

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, ne prej ekzekutivit shoqëria civile Violet Ipshi-Bujupi dhe Imri Bajraktari, prej biznesi po e caktojmë Valentina Sejdiu d.m.th kuota gjinore po plotësohet

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi propozimet janë

Edon Nishori anëtar nga PDKRLL

Jahir Hjadari anëtar nga PDK

Egzon Qorri anëtar nga LDK

Violeta Ipshi-Bujupi anëtar nga shoqëria civile

Valentina Sejdiu anëtar nga komuniteti për biznes

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi hodhi në votim pikën e pare të rendit të ditës1.

Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete;

Për votua 24 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e dytë të rendit të ditës2. Propozim-vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
Me qensë I kemi propozimete e presim edhe një anëtarë nga kuvendi me ju bashku kush do që bëhët kryesues I komitetit për komunitete e hodhim në votim pikën e dytë të rendit të ditës

Për votua 23 Kundër 0 Abstenim 0,

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e tretë të rendit të ditës 3. Plani i punës i Kuvendit Komunal për vitin 2026;

Xhavit Drenori në diskutim me kolegën Egzonën në material i kemi marr datat që më shumë janë tentative se sa që janë fikse dhe pas diskutimit erdhëm në përfundim që mandje ndoshta është edhe pak e arsyeshme sepse mund të këtë ndonjë inpenjim kryetari ose ekzekutivi që s'mundemi me i mbajte megjithatë për neve kishte me qenë e rëndësishme që prej fillimit me u ditë datat për me u përgatiti por kjo nuk është qështja kryesore për të cilën dëshiroj me diskutu ky është plani i punës kuvendit që ka 27 anëtar të kuvendit ndërsa ky tjetri është plani i punës së kryetarit për kah volumi unë e kuptoi që i ka 12 drejtori, unë mendoj që brenda këtij plani ne duhet me e gjete hapësirën tonë të veprimit të kërkesave nevojave të qytetareve të cilët na kanë

delegu këtu, këto propozime që po i bëj brenda kësaj pikë të rendit të ditës besoi që janë të analizume nuk janë thjesht sa për një konsum me dal para jush, sipas këtij plani planifikohen 11 mbledhje të rregullta dhe mbledhjet tjera që kanë me qenë solemne edhe eventualisht të jashtëzakonshme ,por ne si anëtar të kuvendit duhet me pas shumë angazhim dhe me e mbajt edhe një mbledhje me e shtua, unë kam mëndu gjatë tetorit dhe në mbledhjen e radhës të rregullt të themelojmë minimum katër komisione me anëtar të kuvendit e këto komisione do ta kishin një mbledhje të veçantë të rregullt unë kam mendu dikun kah tetori nëntori sepse ka shumë prej kolegeve që janë të ri në kuvendin komunal dhe ju duhet pak kohë me u adaptu edhe me punën edhe me përgjesisë që kemi në qoftëse ne i bëjmë këto komisione unë jam i sigurt që jo vetëm kryetari që ka qenë si deri me tani kampion por për performanc por edhe ne si kuvend komunal kishim me qenë kampion në performanc, dhe në angazhim sepse nëse mbesim vetëm në pikat e rëndit të ditës që vijnë këtu propozimet dhe dalim secili prej neve i diskutojmë me aq sa kemi njohuri ,neve brenda na sjellën dokumente të fushave të ndryshme për mua personalisht është e vështirë me ditë esencën e saj sepse nuk jam ekspert i saj fushë qëllimi i jonë është me bërë me të mirën e mundshme po them sinqerisht nëse i bëjmë këto komisione dhe, edhe një mbledhje shtesë dhe në vitin e ardhshëm me shtu një në gjashtë mujorin e parë dhe një në gjashtë mujorin e dytë jam i sigurt që anëtarët e kuvendit kishin mundur me u aktivizu në këto komisione për me bërë punë të mira për qytetaret, pozitë e opozitë në nivel lokal nuk ka vetëm në nivel qendror këtu kryetari zgjidhet veçmas dhe për 4 vite na pëlqeu nuk pëlqeu sikurse edhe neve, vetëm në qoftëse bëjmë ndonjë gabim të madh dikush dhe e sanksionon ligji sepse kryetari nuk mundet me na largu pra të dy palët jemi të deleguar nga qytetaret, pra unë po propozoj që të shtohet edhe një mbledhje në tetor ose nëntor ,dhe në mbledhjet e radhës ti bëjmë komisionet për monitorimin e projekteve komunale

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi sqaron për planin e punës e përmbledh një vjeqarin e punës së kuvendit ku brenda vit duhet të mbajë 11 mbledhje ashtu edhe si e kemi paraparë po në qoftëse është nevoja debatojmë edhe në KPF dhe i japim rekomandimet tona për kuvend.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, sipas ligjit e rregulloreve janë 11 mbledhje të rregullat një muaj e keni pushim Gushtin e keni caktu ,unë detyrohem me ju përshtatë planit të juaj për pjesëmarrje në kuvend se sepse humbi pikë për grand të performances nëse nuk marr pjesë në mbledhje dhe me marrëveshje i caktojmë datat për mbledhje.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi hodhi në votim pikën e 3. Planin e punës i Kuvendit Komunal për vitin 2026;

Për votua 21 Kundër 0 Abstenim 2

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e katër të rendit të ditës.4 Planin e Punës së Kryetarit dhe drejtorive komunale për vitin 2026;

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Xhaviti e përmbledhi si material i voluminoz, ne e kemi 12 drejtori 7 njësi tjera komunale e kemi pas materialin 200 faqe jemi mundu me zbrit jemi mundu me e përmbledhë të gjitha.

Xhavit Drenori , nuk thash që është i shumtë, po plani i punës së kuvendit është shumë i vogël në krahasim me planin e kryetarit.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi hap për diskutim pikën e pestë 5. Planin Lokal i Veprimt në Mjedis 2025–2029;

Arbër Halilaj i përshëndet të gjithë të pranishmit dhe i dëshiron suksese dhe mendoj që janë shumë me të vogla dallimet që na ndajnë se ato që i kemi të përbashkëta kështu që besoi shumë që mund të gjejmë një gjuhë uniteti dhe angazhimi të përbashkët për atë që përfaqësojmë këtu. Plan Lokal për Veprimin në Mjedis të Komunës së Drenasit.

Ngjashëm me komunat tjera në Kosovë, edhe komuna jonë ka probleme të pazgjidhura mjedisore, që kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, menaxhimin e mbeturinave, shpyllëzimin dhe shkatërrimin e biodiversitetit, florës e faunës etj.

PLVM i komunës së Drenasit është një dokument strategjik dhe obligim ligjor sipas nenit 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, i cili Plan Lokal duhet të jetë në harmoni me Planin e Veprimit Kombëtar në Mjedis (PKVM), Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit (SKMM), Strategjinë për ndryshimet klimetike 2019- 2028 dhe dokumentet tjera që merren me mjedisin jetësor dhe përmirësimin e gjendjes së tij.

Përkundër ndërmarrjes së disa veprimeve e projekteve për përmirësimin e gjendjes, ka vazhduar degradimi i burimeve natyrore (pyjeve, tokës bujqësore, burimeve ujore, florës e faunës etj.), gjë që është shqetësuese jo vetëm për ne, por edhe për faktin se këto resurse nuk janë pronë e një gjenerate por duhet të ruhen edhe për gjeneratat pasuese.

Komuna jonë ende ka një sërë sfidash të pazgjidhura mjedisore, siç janë: trajtimi dhe menaxhimi i ujërave të ndotura, menaxhimi i mbeturinave, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe e tokës bujqësore, furnizimi me ujë të mjaftueshëm e cilësor për pije.

Plani Lokal për Veprim në Mjedis (2025-2029), që e kemi sot para vetes, i cili konstaton gjendjen aktuale mjedisore, poashtu përcakton edhe prioritetet sa i përket çështjeve mjedisore në periudhën e cekur pesëvjeçare (2025-2029). Ky Plan, i bazuar edhe në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale, është mundësi e mirë për planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke adresuar dhe ofruar zgjidhje për problemet mjedisore në nivel lokal. Por, disa masa e veprime shtesë, duke u mbështetur edhe në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit, mendoj se do ta plotësonin edhe më tepër këtë plan, e që do t'i theksoj në vijim:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve:

- Organizimi i fushatave edukative për qytetarët mbi rëndësinë e ruajtjes së burimeve natyrore dhe menaxhimit më të mirë të mbetjeve – është hapi i parë, që sa e kam analizuar është përfshirë në këtë PLVM, por vetëm lypset të konkretizohet në veprime dhe faza kohore.
- PROPOZIM SHITESË: Komuna dhe DKA të ngrisin çështjen e integritetit të mbrojtjes mjedisore në kurrikulat shkollore, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

2. Përdorimi i energjisë së ripërtëritshme (PROPOZIME SHITESË)

- Duhet të Inkurajohen dhe mbështeten më tepër projektet e përdorimit të energjisë solare dhe të erës, si burime të ripërtëritshme.
- Subvencionimi i instalimit të sistemeve të ngrohjes solare në ndërtesat publike dhe private.

3. Ruajtja e biodiversitetit (PROPOZIME SHITESË)

- Ruajtja e habitatit natyror nga shkatërrimi, sidomos në vendet me potencial edhe turistik, siç është Liqeni i Vasilevës.
- Zhvillimi i projekteve për mbrojtjen e specieve të rrezikuara të florës dhe faunës.
- Implementimi i një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm të biodiversitetit, duke krijuar një bazë të të dhënave për monitorimin e florës dhe faunës lokale.